

UDHËZIM
Nr. 26, datë 17.12.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 3, DATË 23.1.2018,
“PËR VLERËSIMIN E MALLRAVE PËR QËLLIME DOGANORE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; në zbatim të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe bazuar në pikat 4 dhe 5, të nenit 161, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.11.2017, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, ‘Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, me qëllim lehtësimin dhe zbatimin praktik nga administrata doganore të procedurës dhe metodologjisë së vlerësimit të mallrave për qëllime doganore, ministri i Financave,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 3, datë 23.1.2018, “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”, të ministrit përgjegjës për financat, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në nënpikën 15.1, të pikës 15, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Në shkronjën “a”, togfjalëshi “*Thomson-Reuters*” zëvendësohet me fjalën “*Refinitiv*”;

b) Në shkronjën “b”, fjala “*Platts*” zëvendësohet me togfjalëshin “*S&P Global Commodity Insights*”;

c) Në shkronjën “c”, togfjalëshi “, si *Metal Bulletin*”, “*Steel Week*” zëvendësohet me togfjalëshin “dhe lingotave të bakrit, aluminit dhe zinkut të marra nga agjencia kombëtare *Fast Market*” dhe “*London Metal Exchange (LME)*”;;

ç) Shkronja “f”, ndryshon si më poshtë:

“Buletine të çmimeve të automjeteve si: “*Quattroruote*”, “*Schwackeliste*” dhe site si “*cars.com*”, “*impact auto*”, “*auto win*”, “*dubizzle*”, “*mobile.de*”, “*dueroute*”;;

d) Shkronja “g” e parë hiqet.

2. Në nënpikën 15.2, të pikës 15, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Togfjalëshi “dhe miratohen nga Komisioni *ad-hoc* në varësi të ministrit të Financave”, hiqet;

b) Pas fjalisë së parë, shtohet fjalia me përmbajtje si më poshtë:

“Drejtoria e Vlerësimit në Qendër i referon komisionit të posaçëm të ngritur për këtë qëllim nga drejtori i përgjithshëm i Doganave, të shqyrtojë propozimet rast pas rasti dhe vetëm pas miratimit nga ky komision reflektohen ndryshimet në “*Dosjen e të Dhënave të Disponueshme*””.

3. Nënpika 15.3, e pikës 15, ndryshon si më poshtë:

“Për artikujt që sigurohen informacione nga burimet e përmendura në nënpikën 15.1, shkronjat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “f”, vendosja dhe rishikimi i çmimeve në “*Dosjen e të Dhënave të Disponueshme*”, bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, pa kaluar në komisionin e posaçëm për këtë qëllim.”.

4. Nënpika 16.1, e pikës 16, ndryshon si më poshtë:

“16.1/a) Për artikujt e karburanteve të tilla si: benzinë, gazoil, vajgur, jet, lëndë djegëse me përmbajtje sulfuri, gaz i lëngshëm (butan, propan), biodizel (dhe të gjitha nënproduktet), naftë bruto, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër harton shkresën me çmimet e përditësuara dhe pas miratimit nga titullari i institucionit ua dërgon degëve doganore dhe strukturave të tjera që ju nevojitet ky informacion. Përditësimi i këtyre artikujve bëhet çdo ditë pune;

16.1/b) Për artikujt lingota bakri, alumini dhe zinku, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër harton shkresën me çmimet e përditësuara dhe pas miratimit nga titullari i institucionit ua dërgon degëve doganore dhe strukturave të tjera që ju nevojitet ky informacion. Përditësimi i këtyre artikujve bëhet çdo ditë pune.”.

5. Nën-pika 16.2, e pikës 16, ndryshon si më poshtë:

“Për artikujt grurë, misër, krunde, oriz, sheqer, vaj ushqimor, kafe, bërsi, elb, tërshërë, produktet e çelikut, hekurit, skrap, llamarinë, profile dhe produkte të tjera prej çeliku etj., plehrat kimike, lëndë e parë plastike dhe bitum, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër harton shkresën me çmimet e përditësuara dhe pas miratimit nga titullari i institucionit ua dërgon degëve doganore dhe strukturave të tjera që ju nevojitet ky informacion. Afati i përditësimit bëhet çdo 2 javë (fillim dhe mes muaji).”.

6. Nën-pika 16.3, e pikës 16, hiqet.

7. Nën-pika 17.1, e pikës 17, ndryshon si më poshtë:

“17.1 Për zhdoganimin e automjeteve, në rastet kur nuk pranohet transaksioni dhe nuk është i mundur përdorimi i metodave të tjera, vlerësimi bazohet në buletinet dhe site-t e cituara në pikën 15/1/f, në të cilat pasqyrohen çmimet e shitjes në tregjet evropiane.”.

8. Nën-pika 17.4, e pikës 17, ndryshon si më poshtë:

“17.4 Vlera për kamionçinë, furgonë dhe kamionë që gjendet në buletinet dhe site-t e cituara në pikën 15/1/f, nisur nga marka, modeli dhe viti i prodhimit nuk duhet të jetë më e ulët se 80% e çmimit të gjendur në tabelë.”.

9. Në pikën 17, shtohet nën-pika 17.5 me përmbajtje si më poshtë:

“17.5 Vlerësimi i automjeteve me vit prodhimi para vitit të fundit të publikuar në këto buletine dhe site nuk mund të llogaritet më pak se çmimet e pasqyruara, si më poshtë vijon:

Për autoveturat çmimet janë:

- a) deri në 1400 cc jo më pak se 162 500 lekë;
- b) mbi 1400-1900 cc jo më pak se 250 000 lekë;
- c) mbi 1900-2500 cc jo më pak se 406 000 lekë;
- d) mbi 2500-3000 cc jo më pak se 500 000 lekë;
- e) mbi 3000-4500 cc jo më pak se 625 000 lekë;
- f) mbi 4500 cc jo më pak se 1 000 000 lekë.

Për kamionçinë, furgonë dhe kamionë, sipas kapacitetit mbajtës çmimet janë:

- a) deri në 1.5 tonë jo më pak se 500 000 lekë;
- b) nga 1.5 tonë deri në 3.5 tonë jo më pak se 750 000 lekë;
- c) nga 3.5 tonë deri në 10 tonë jo më pak se 1 062 500 lekë;
- d) nga 10 tonë deri në 15 tonë jo më pak se 1 250 000 lekë;
- e) mbi 15 tonë jo më pak se 1 500 000 lekë.”.

9. Pika 18, hiqet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj